

Pas kaq vitesh në drejtimin e Sicred Assistance shpk, jam krenare që sot me publicitet vlerësoj punën e bërë nga punonjësit e Sicred Assistance gjatë vitit 2018. Është e ndershme të pohosh se gjatë këtij viti të përmbyllur në Dhjetorin e 2018, u përdorën të gjitha mundësitë objektive dhe përpjekjet e punonjësve të kësaj njësie dhanë drejtpërdrejt impakt në rezultatin e vitit.

Shqipëria fatmirësisht nuk ka shënuar gjatë 2018 dëmtime masive të punëmarrësve për shkak të ngjarjeve të paparashikuara në vendet e punës apo ngjarje katastrofike, të cilat kanë provokuar pasoja të rënda në shëndetin e punëmarrësve, megjithatë kjo nuk nënkupton që shërbimet në vijimësi të përmirësimit të kushteve të punës apo nivelit të dijeve për identifikimin dhe shmangien e riskut në mjediset e punës duhet të kufizohen.

Ndërkohë që progresi teknologjik në përmirësimin e kushteve të punës dhe mjeteve që përdorim për të kryer punën është në përmirësim të vijueshëm dhe i pandalshëm, ne duhet të jemi të vëmendshëm ndaj çdo incidenti me pasoja në shëndetin e punonjësve në vendet e tyre të punës.

Përgjatë vitit 2018 duhet të përmendim se shoqëria Sicred Assistance, fatmirësisht nuk ka të regjistruar nga klientët e saj asnjë rast të referuar të aksidentit në mjediset e punës dhe me pasoja në shëndet.

Me realizëm duhet të shprehemi se gjatë vitit 2018, kemi siguruar më shumë kërkesa për shërbime të sigurisë dhe shëndetit në punë nga klientë të rinj, fakt që afirmon se dobia e këtij shërbimi është e matshme dhe tregu për këtë shërbim po edukohet.

Shoqëria Sicred Assistance përgjatë vitit 2018 arriti të ofrojë me profesionalizëm dhe kurajë shërbime për shëndetin dhe sigurinë në punë tek klientët, duke përforcuar metodat e komunikimit me punëdhënësit, në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe kushteve të punëmarrësve të klientëve të saj. Synim i qartë në këtë marrëdhënie është përforcimi i kuptimit të çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë në frymën e duhur, por edhe i qasjes optimale për të pasur rezultatet e duhura në shmangien e rreziqeve që vijnë nga puna apo për shkak të punës në shëndetin e punëmarrësve.

Është me vend që publikisht të përsërisim se duke u marrë rregullisht, pa shkujdesje dhe në mënyrë profesionale me çështjet e sigurisë e duke i transmetuar ato drejt tek klientët tanë, vetëm kështu do arrijmë të ndërtojmë, përforcojmë dhe edukojmë politika që realisht mbështesin vëmendjen ndaj riskut të shëndetit në punë dhe mundësisht shmangien për aq sa është e mundur të çdo aspekti me pasojë negative që ky risk mund të transmetojë tek punëmarrësit.

Jemi krenare që përgjatë rrugëtimit tonë në këshillimin e subjekteve punëdhënëse për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, kemi mësuar nga klientët tanë të përmirësojmë gjykimin mbi çështjet themelore për sigurinë e shëndetin në punë e në këtë mënyrë te përforcojmë sistemin e komunikimin e vazhdueshëm mes aktorëve që ndikojnë drejtpërdrejt në këtë proces shumë të rëndësishëm me impakt të drejtpërdrejtë në jetën e shëndetin e fuqisë punëtore aktive.

Ne drejtim të shërbimit të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë vitit 2018 rezulton se shoqëria ka mundur të masë dhe të vlerësojë përmirësimin e dukshëm në dhënien e këtij shërbimi, fakt që është drejtpërdrejtë transmetuar në rritjen e reputacionit dhe efektivitetit të shërbimeve të saj në tregun shqiptar.

Gjithsesi ne jemi në rolin tonë funksional, kritike për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, të hasura në mjediset që kemi këqyruar dhe hetuar duke siguruar një vijimësi me tendencë përmirësim të përpjekjeve për të pasur mjedise që sigurojnë shëndetin dhe sigurinë në punë të punëmarrësve aktive.

Nën këtë kontekst duam të falënderojmë të gjithë bashkëpunëtorët tanë që me mendjemprehtësi pranuan rekomandimet tona, i përjasën ato me altruizëm dhe kështu përftuan rolin e një faktori konstruktiv e bashkëpunues në gjetjen e rrugës së duhur për adresimin dhe trajtimin e çështjeve të sigurisë dhe të shëndetit në punë.

Përgjatë vitit 2018 ne me besim të plotë punuam në drejtimin e duhur e megjithëse arritëm të siguronim një rezultat pozitiv financiar duke siguruar kështu stabilitet në veprimet tona, me ndershmëri mund të pohojmë se nuk arritëm dot të trajtojmë si duhet çështjet e demografisë së fuqisë punëtore.

Mbetet sfida për vitin 2019 për shoqërinë SiCRED Assistance hulumtimi dhe analizimi i incidencave të pazakonta shëndetësore, përfshirë nevojat e punonjësve të moshuar, punonjësve me moshë të re, punonjësve me aftësi të kufizuara, gjithaq problemet e sigurisë dhe shëndetit të grave.

Në vëmendjen tonë për vitin 2019 janë edhe incidencat e pazakonta në shëndetin mendor, që vijnë si rrjedhojë e stresit, apo dhunës verbale dhe psikologjike të përdorur në mjediset e punës.

Çështjet e ndërmjetësimit për punë gjatë vitit 2018 nuk shënuan ndonjë progres në shoqërinë SiCred Assistance. Me gjithë përpjekjet tona nuk mundëm të siguronim rezultate të matshme në ndërmjetësimin në punë të punëkërkuesve apo në ndërmjetësimin në marrjen e shërbimit mjekësor pranë subjektit më cilësor.



Megjithëse në filozofinë e shërbimeve të shoqërisë të tre dimensionet e aktivitetit kanë një qasje deri diku natyrale, deri tani nuk kemi mundur të sigurojmë me metodat e përdorura suksesin e matshëm në shërbimet e ndërmjetësimit në punësim apo ndërmjetësimit në gjetjen e institucionit të përshtatshëm shëndetësor.

Të ndërgjegjshëm dhe të vëmendshëm sot ndaj ndarjes së dallueshme dhe të qëndrueshme në vendin tonë të perspektives ekonomike dhe sociale, po aq të vëmendshëm edhe ndaj prezencës së varfërisë, jemi të aftë të arsyetojmë, se të dy këto dimensione të aktivitetit tonë janë të vështira për të matur efikasitetin.

Gjithsesi përgjatë 2019, besojmë dhe kemi punuar të përftojmë rezultate të matshme në drejtim të ndërmjetësimit në punësim, duke realizuar në 100 vjetorin e themelimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) edhe rezultatet tona të para të aktivitetit në këtë drejtim.

Të inspiruar nga parimet më të larta, që në mjedisin tonë të mundemi sa më shumë të zvogëlojmë problematikat sfiduese që përcillen në marrëdhëniet e punës, nga prezenca e varfërisë, shpejtësia me të

cilën ecën teknologjia, pasqyrimi me diferenca i zbatimit të të drejtave të punës, lëvizjet demografike, globalizimi, emigrimi dhe migrimi, si dhe ndryshimet e paparashikuara të klimës, ne jemi të ndërgjegjshëm se me përpjekje çdo dite, mund të reduktojmë erozionin e multilateralizimit.

Sicred Assistance me vëmendje të veçantë tek sigurimi i kushteve për të pasur afirmim të kontratës sociale, vlerëson si me shumë rëndësi strategjinë që kontribuon në ruajtjen e shëndetit si dhe sigurinë e tij, po aq edhe vëmendjen për kontrollin të vazhdueshme në institucionet më të mira mjekësore.

Vizioni i qartë dhe besimi të puna në drejtimin e duhur, na bëjnë të jemi të qartë në kapacitetet tona dhe nevojat për t'u zhvilluar në të tre dimensionet e aktivitetit tonë. Përgjatë vitit 2019 do të ruajmë stabilitetin financiar të vitit të mbyllur në 31 Dhjetor 2018, duke synuar realizime konkrete në të drejtimit e aktivitetit tonë.

Të vetëdijshëm që kemi shumë punë për të bërë në vijimësi në të tre dimensionet e aktivitetit tonë, jemi besimplotë se nesërmja do të shënojë më pak të dëmtuar me pasoja serioze për shëndetin në punë, punonjës aktivë të shëndetshëm me mundësinë që çdo problem shëndetësor të mund ta zgjidhin pranë institucionit mjekësor më të mirë, si dhe punonjës që trajtohen denjësisht në punë pa dallim, gjinor, racor apo etnik.

*Vetëm së bashku mund të sigurojmë një të ardhme më të sigurt, të shëndetshme dhe dinjitoze për çdo punonjës*

*Sinqerisht*

*Vjosa Bodo Mujo*

*Administrator*

*Sicred Assistance shpk*